



RAPORT MONITORIMI
AUTOR
RENIS META

“Të Dbuemit”

Eksodi i të rinjve nga
Shqipëria, mungesa e
vizionit dhe apatia
qeverisëse”

QENDRESA
QYTETARE



www.qeverisja.qq.com.al



**Tjera fushë e tjera zalle
Kam me pa, e tjera dete:
Kam me ndie, po, tjera valle,
Tjera gjuhë, n'tjera qytete;
Vendin tem, por s'kam me pa,
Ku kam le e jam burrnue;
Syt e mi edhe kamë me kja,
Pa u gjetë kush qi me i ngushllue.**

Titulli i këtij raporti është frymëzuar nga "I dbuemi" (1909), lirikë e mallit universal për atdheun, pjesë e "Mrizi i Zanave" (1913), kryevepër e lirikës së At Gjergj Fishtës. Botuar për herë të parë në vitin 1909, vargjet e Fishtës duket se ende sot shpërfaqin dramën e Shqipërisë dhe të rinjve Shqiptarë që detyrohen të largohen nga vendi i tyre për shkak të mungesës së aspiratave dhe dergjen gjithkund me shpresën për një jetë më të mirë.



Hyrje

Emigrimi ka qenë pjesë e pandarë e zhvillimit të historisë së Shqipërisë dhe ende vijon të mbetet një plagë e vendit. Shqipëria e post-komunizmit ka një histori të dhimbshme të emigrimit, që daton nga fillimi i viteve 1990 e deri në ditët e sotme. Ndërkohë që vendi ishte përballë tranzicionit nga një sistem totalitar në një sistem demokratik, Shqipëria u përball me një emigracion intensiv dhe në përmasa të mëdha (WFD & IDI, 2021., fq.7)¹. Studiuesi Russell King (2005), në një nga punimet e tij, e konsideronte Shqipërinë si një laborator ideal për të studiuar fenomenin e emigrimit. Thujse dy dekada më pas, duket se ky konstatim është më aktual se kurrë. Në ditët e sotme, referuar shifrave, fatkeqësisht Shqipëria vazhdon të mbetet hapësira sui generis ideale për të studiuar fenomenin e emigrimit, veçanërisht në moshat e reja.²



¹ Westminster Foundation for Democracy & Institute for Development and Innovation. (2020) The Cost of Youth Emigration in Western Balkan Countries: Regional Overview.

² King, Russell. (2005). Albania as a Laboratory for the Study of Migration and Development. Journal of Southern Europe and the Balkans. 7. 133-155. 10.1080/14613190500132880.

Në Shqipëri, emigrimi përfshin veçanërisht të rinjtë (INSTAT, 2020, f.23).³ Emigrimi i të rinjve nuk është një fenomen i ri apo i panjohur për shoqërinë Shqiptare, që prej kohësh vendi lëngon nga një hemoragji e vazhdueshme e të rinjve.

Në një kohë kur Tirana është shpallur Kryeqyteti Europian i Rinisë, Shqipëria po përjeton një eksod të konsiderueshëm të të rinjve. Sipas INSTAT, në vitin 2020, edhe pse në kohë pandemie, janë larguar 23.854 persona. Të rinjtë përbëjnë numrin më të madh të tyre. **Popullsia në grup-moshën 15-29 vjeç u zvogëlua me rreth 18 mijë persona.**

Emigrimi në Shqipëri ka qenë subjekt i një ndryshimi të vazhdueshëm në intensitet dhe karakterin e tij gjatë këtyre tre dekadave (Gëdeshi.I., 2021, f.5).⁴ Kryesisht emigrimi në Shqipëri, ka qenë i një karakteri informal dhe pjesa më e madhe e atyre që linin vendin kishin një nivel të ulët arsimimi, por në vitet e fundit emigrimi i të rinjve ka marrë një tjetër trajtë në përmasa të mëdha, në atë që njihet si fenomeni “i largimit të trurit”.



Përmasat e largimit të të rinjve në formën e Braindrain (largimit të trurit)

Shqipëria po përjeton kohë të vështira për të mbajtur në vend të rinjtë dhe njerëzit me arsim të lartë dhe të kualifikuar, që po emigrojnë drejt vendeve të tjera në shifra të larta, duke e bërë Shqipërinë një nga vendet e para në rajon dhe më gjerë për peshën dhe intensitetin e emigracionit në nivel ndërkombëtar (Gëdeshi.I., 2021, f.45)⁵.

³ INSTAT. (2020). Diaspora e Shqipërisë në shifra.

⁴ Gëdeshi.I. (2021). How Migration, Human Capital And The Labour Market Interact In Albania

⁵ Gëdeshi.I. (2021). How Migration, Human Capital And The Labour Market Interact In Albania.

Të dhënat e fundit mbi përmasat e largimit të të rinjve dhe trurit nga Shqipëria vijnë nga raporti i publikuar nga Vienna Institute for International Economic Studies (2021)⁶, që ka marrë në analizë përbërjen dhe nivelin e edukimit dhe kualifikimit të popullatës së larguar nga vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, për periudhën kohore 2011-2019.

Raporti zbulon se në Shqipëri, emigracioni neto ndodh në të gjitha grup-moshat, por kryesisht ndër grup-moshat më të reja, të cilët kanë predispozicion më të lartë për të lënë vendin. Ndërsa emigracioni neto në rajon ndodh kryesisht në mesin e atyre me arsim të mesëm dhe të ulët, në Shqipëri emigracioni neto është më i lartë tek ato me arsim të lartë dhe ato me arsim e kualifikim të mesëm dhe të lartë profesional, që është një tregues i qartë i rrjedhjes së konsiderueshme të trurit (f.10). Sipas raportit, Shqipëria ka pasur një emigrim të konsiderueshëm neto të personave me arsim të lartë, të vlerësuar në rreth 40,700 persona, dhe përbën pothuajse 40% të daljeve totale kumulative prej 105,000 personash midis viteve 2012 dhe 2019 (f.38). Largimi i trurit është më i dukshëm dhe i përhapur gjerësisht në mesin e më të rinjve, veçanërisht në mesin e individëve që janë në grup-moshën 20-24 vjeç, si dhe deri në 29 vjeç, të cilët rezultojnë të kenë përfunduar arsimin e lartë në Shqipëri. Gjithashtu, largimi i trurit evidentohet edhe midis personave në të 30-at deri në fillim të të 40-tave (f.38).



Duke pasur në konsideratë dhe karakterin informal të emigrimit në të shkuarën, tendenca për të emigruar ka qenë gjithmonë mbizotëruese tek burrat dhe djemtë, të cilët kanë qenë më të prirur për t'u larguar nga vendi, më tepër se tek gratë e vajzat (INSTAT & IOM., 2014, f.58)⁷. Por, fenomeni i largimit të të rinjve në formën e braindrain (largimit të trurit), duket se ka nxjerrë në pah tendencën e grave dhe vajzave me arsim të lartë dhe të kualifikuara, për të emigruar. Evidentohet se shifrat e grave dhe vajzave që duan të lënë vendin janë edhe më të larta në fushën e mjekësisë dhe infermierisë (Gjypi.Sh.A., 2018, f.68)⁸.

⁶ Leitner M. S. (2021). Net Migration and its Skill Composition in the Western Balkan Countries between 2010 and 2019: Results from a Cohort Approach Analysis. The Vienna Institute for International Economic Studies.

⁷ INSTAT & IOM. (2014) Return Migration and Reintegration in Albania 2013. ISBN: 978-9928-188-14-4

⁸ Gjypi.Sh.A. (2018). Largimi i Mjekëve nga Shqipëria "Together for Life" & Friedrich Ebert Foundation.

Për më tepër, largimi i trurit nga Shqipëria është më i lartë në mesin e të porsadiplomuarve në universitete (Leitner.M. S, 2021)⁹.

Përpos humbjes së vazhdueshme të kapitalit njerëzor, largimi i të rinjve në formën e “braindrain” mbart një barrë të rëndë socio-ekonomike për Shqipërinë në një periudhë afatgjatë. Veçanërisht, të rinjtë që studiojnë në fusha të caktuara si: mjekësi, infermieri (Gjypi.Sh.A., 2018, f.68, 69), informatikë dhe inxhinieri, kanë një tendencë më të lartë për të lënë vendin (King.R dhe Gëdeshi.I. 2020, f. .66, 67)¹⁰.

Referuar Westminster Foundation for Democracy, arsimi i një të riu në Shqipëri që ka përfunduar edukimin në vitin 2018, në varësi të nivelit arsimor të përfunduar, kushtonte rreth 6,000€ për arsimin fillor, rreth 9,300€ për arsimin e mesëm dhe rreth 18,300€ për studimet e përfunduara akademike, dhe një mesatare prej 32,000€ për studimet e përfunduara pas-universitare (PhD) (WFD & IDI, 2021., f.7)¹¹.

Situatë alarmante mbetet largimi i studentëve që studiojnë mjekësi dhe mjekëve të rinj e të kualifikuar, **78% e mjekëve e mendojnë largimin nga Shqipëria**, 24% e të cilëve janë gati të largohen menjëherë, ndërsa 54% do të largoheshin nëse do t'u jepej mundësia. Situata më sfiduese paraqitet në qendrat universitare, ku edhe mjekët kanë tendencën më të madhe për t'u larguar nga vendi. Shihet një tendencë në mjekët me grada të larta shkencore të cilët duan të largohen nga Shqipëria, 40% e të cilëve e konsiderojnë të rëndësishëm largimin nga Shqipëria (Gjypi.Sh.A., 2018, f.67). Mjekët evidentojnë si më shqetësuese, problemet strukturore të sistemit shëndetësor, financimin dhe burokracitë e sistemit, si dhe mungesën e sigurisë financiare (Gjypi.Sh.A., 2018, f. 68)¹².



⁹ Leitner M. S. (2021). Net Migration and its Skill Composition in the Western Balkan Countries between 2010 and 2019: Results from a Cohort Approach Analysis. The Vienna Institute for International Economic Studies.

¹⁰ King.R and Gëdeshi.I. (2020). The actual and potential migration of students from Albania: a putative Brain Drain?

¹¹ Westminster Foundation for Democracy & Institute for Development and Innovation. (2020) The Cost of Youth Emigration in Western Balkan Countries: Regional Overview.

¹² Gjypi.Sh.A. (2018). Largimi i Mjekëve nga Shqipëria “Together for Life” & Friedrich Ebert Foundation.



Pasojat që mbart largimi i të rinjve dhe elitës intelektuale

Ndërsa gjerësisht në literaturën e emigrimit diskutohet se fenomeni i ikjes së trurit mund të sjellë përfitime, sepse shkakton flukse të remitancave në ekonominë shqiptare, kostot socio-ekonomike ende peshojnë dukshëm më shumë se përfitimet.

Referuar INSTAT (2020), emigrimi vazhdon të luajë një rol shumë të rëndësishëm në dinamikën e popullsisë. Sipas INSTAT (2020), emigracioni përfshin një popullsi relativisht të re dhe në moshë pune dhe kjo vihet re për të dy gjinitë (f.25)¹³. Bazuar në flukset dalëse të popullsisë, ashtu sikurse projeksionet e popullsisë sugjerojnë, popullsia e Shqipërisë po shkon drejt procesit të plakjes, si pasojë e uljes së lindshmërisë dhe rritjes së jetëgjatësisë dhe për më tepër emigracionit, i cili vazhdon të mbetet veprues dhe që përfshin një popullsi relativisht të re. (f.23, 24)¹⁴

Lokomotiva e zhvillimit ekonomik dhe social, pjesa më e mirë e kapitalit njerëzor, e cila po ikën në ritme të larta, mbart një ndikim të madh në kapacitetin prodhues në nivel kombëtar dhe vendor, duke sjellë kështu një tkurrje në aktivitetin dhe efektivitetin prodhues të vendit.

Largimi i të rinjve dhe veçanërisht i të rinjve të arsimuar, ka sjellë mungesën e theksuar të kapaciteteve profesionale, menaxheriale dhe një mungesë të rëndë në forcën punëtore të vendit, veçanërisht në sektorin privat. Në terma afatgjatë, ekonomia e vendit është e prirur të vuajë pasojat e rënies së fuqisë punëtore për shkak të uljes së popullsisë në moshë pune. Po ashtu, një pjesë e mirë e sektorëve të ekonomisë janë të prirur të mbeten pa punonjës të kualifikuar.

Ndikimi të skema e pensioneve është po aq i rëndë dhe mund të sjellë përmbysjen e raportit kontribues-përfitues të skemës së pensioneve, ç'ka do të thotë më shumë para nga buxheti i shtetit për të mbuluar deficitin e skemës së pensioneve.

¹³ INSTAT. (2020). Diaspora e Shqipërisë në Shifra.

¹⁴ INSTAT. (2020). Diaspora e Shqipërisë në Shifra.



Problemet në sistemin arsimor në Shqipëri, një faktor shtytës?

Shqipëria kryeson ndër vendet e rajonit për numrin e studentëve që studiojnë jashtë vendit, ku vetëm një pjesë e vogël e tyre shprehin dëshirën për t'u kthyer në Shqipëri (Gëdeshi.I., 2021, f.45). Duke hulumtuar ndër faktorët që shtyjnë të rinjtë dhe trurin e vendit të largohen, sistemi arsimor në Shqipëri evidentohet si një faktor përcaktues për të lënë vendin.

Problemet që ndikojnë në cilësinë e sistemit arsimor duket se burojnë pjesërisht nga mungesa e buxhetimit adekuat për nevojat që paraqet sistemi arsimor. Një përqindje e ulët e GDP-së së Shqipërisë shkon për edukimin, përqindje relativisht më e ulët krahasimisht me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe dukshëm më e ulët se vendet e Bashkimit Europian. Sistemi arsimor dhe problemet strukturore në të duket se janë një faktor shtytës për emigrimin e pjesës më të gjallë të shoqërisë, studentëve dhe akademikëve (King.R dhe Gëdeshi.I., 2020, f.28)¹⁵.

While comparing universities in Albania and in the UK, Andra, a master's student, shares her experience:

Universities abroad engage students in an active learning process, through dialogue. The whole process is student-centred, which means that you do not have text books, but each week the student is given a list of study materials and when you go to class the professor explains. In Albania, on the contrary, you have a textbook, and you learn it after the Professor has explained it in class. That is you are one step behind, you are very dependent on the text book and you do not have any alternative questions.

Similarly, Besjan, a student in Germany, says:

Teaching in German universities is totally different from teaching methods in Albania. It does not rely on the approach: tell-learn-recite.

Për më tepër, studentët shqiptarë rendisin një sërë problematikash lidhur me mungesën e literaturës, pamundësinë për të zhvilluar kërkim shkencor dhe lidhjen e munguar mes qasjeve teorike dhe praktike, si faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e arsimimit të tyre.

Për më tepër, studentët përballen me një nivel të lartë të shpenzimeve dhe kostove mujore studentore, që tejkalojnë pagën minimale në Shqipëri. Sipas raportit të fundit të Qëndresës Qytetare (2021), vetëm 7% e studentëve në Tiranë janë të akomoduar në konvikte, gjë që pamundëson jetesën e tyre. Po ashtu, kushtet e konvikteve për akomodimin e studentëve kanë qenë kushte të mjerueshme dhe jo dinjitoze.

Vëmendja ka qenë thujtë inekzistente kundrejt problematikave të akomodimit në sistemin arsimor. Vëmendja u shtua vetëm nën tryshinë e

¹⁵ King.R and Gëdeshi.I. (2020). The actual and potential migration of students from Albania: a putative Brain Drain?

protestës së studentëve, ku qeveria u detyrua të zbatojë me emergjencë një marrëveshje granti të nënshkruar në vitin 2016 me Bankën Gjermane për Zhvillim (KFW) për rikonstrukcionin e konvikteve të studentëve në Tiranë, sipas parimit të efikasitetit të energjisë në vlerën 18.8 milion euro.¹⁶



Shumica e studentëve shqiptarë e konsiderojnë studimin jashtë Shqipërisë si hapin e parë drejt të vendosurit jashtë vendit në të ardhmen (f.53). Studentët shqiptarë tundohen të qëndrojnë dhe të ndjekin karrierën e tyre jashtë vendit pas diplomimit. Kjo vjen si rrjedhojë e perceptimit se rikthimi dhe jetesa në Shqipëri u jep atyre mundësi të kufizuara për zhvillimin e tyre profesional dhe karrierën e tyre (King.R dhe Gëdeshi.I., 2020, f.28)¹⁷.

Për më tepër, studentët shqiptarë rendisin një sërë pengesash që i ndalojnë të kthehen në Shqipëri, duke filluar nga vështirësitë për të gjetur një punë, pagat e ulëta (King.R dhe Gëdeshi.I., 2020, f.57)¹⁸, e deri tek mospërputhja e numrit dhe profilit të të diplomuarve me kërkesat e tregut të punës, duke i bërë të rinjtë të hasin vështirësi për t'iu përshtatur kërkesave të tregut të punës (Gëdeshi.I., 2021, f.45)¹⁹. Ndërkohë, në të njëjtën linjë, **54 përqind e të rinjve në Shqipëri pohojnë se do ta kishin të vështirë e shumë të vështirë të gjenin një punë pas përfundimit të ciklit të tyre të shkollimit** (FES, 2019, f.45)²⁰. Kryesisht, të rinjtë që shprehin dëshirën për t'u kthyer në Shqipëri kanë prindërit biznesmenë ose zyrtarë të lartë të shtetit, duke krijuar një siguri më të lartë për të pasur mundësi të sigurt punësimi dhe të përparimit të karrierës së tyre (King.R dhe Gëdeshi.I., 2020, f.59)²¹.

¹⁶ Qëndresa Qytetare. (2019). Monitorimi i Paktit për Universitetin. Janar-Nëntor 2019.

¹⁷ King.R and Gëdeshi.I. (2020). The actual and potential migration of students from Albania: a putative Brain Drain?

¹⁸ King.R and Gëdeshi.I. (2020). The actual and potential migration of students from Albania: a putative Brain Drain?

¹⁹ Gëdeshi.I. (2021). How Migration, Human Capital and The Labour Market Interact in Albania

²⁰ Fondacioni "Friedrich Ebert". (2019). Rinia Shqiptare 2018/2018.

²¹ King.R and Gëdeshi.I. (2020). The actual and potential migration of students from Albania: a putative Brain Drain?



Faktorët shtytës – Largimi i të rinjve rrjedhë e kontekstit ekonomik dhe socio-politik

Problemet në sistemin arsimor nuk janë të vetmet arsye që po i shtyjnë të rinjtë të largohen nga Shqipëria. Emigrimi i të rinjve dhe elitës intelektuale është një fenomen që i ka rrënjët në mundësitë e pakta ekonomike që ofron vendi ynë, në mjedisin social dhe “habitatit politik” të vendit. Por arsyet për të cilat të rinjtë dëshirojnë të largohen nga Shqipëria, mbeten kryesisht të një natyre ekonomike (FES, 2019, f.38)²², dhe shpesh janë kombinim i disa faktorëve si papunësia, pagat e ulëta, varfëria apo mangësitë në mbrojtjen sociale.

Referuar studimit kombëtar “Rinia Shqiptare 2018-2019”, (Friedrich Ebert, 2019)²³, rreth 40 përqind e të rinjve shqiptarë shprehin një dëshirë të lartë të jetojnë larg Shqipërisë dhe shumica e tyre, të jetojnë përgjithmonë, ndërsa 20 përqind shprehin një dëshirë të moderuar për të emigruar. Arsyet kryesore që fshihen pas dëshirës së lartë për të lënë vendin janë kërkesa për standarte më të mira të jetesës dhe për një punësim më të kënaqshëm, ndërkohë që arsimi renditet si motivi dytësor për t’u larguar’.

Por kjo është vetëm maja e ajsbergut kur bëhet fjalë për zhgënjimin dhe frustrimin e të rinjve shqiptarë që zgjedhin të lënë vendin, për shkak të korrupsionit, nepotizmit, promovimit në bazë të kriterëve jo profesionale, mungesës së meritokracisë, vlerësimit dhe aspiratave të tyre në Shqipëri. Papunësia e të rinjve vijon të mbetet një nga arsyet thelbësore për largimin e tyre nga vendi, pasi janë pikërisht të rinjtë e diplomuar ata që vuajnë nivelet më të larta të papunësisë.

Sfidat bëhen më të dukshme kur të rinjtë hasin vështirësi për gjetjen e një pune për shkak të korrupsionit dhe nepotizmit, pamundësisë për të përparuar në karrierën e tyre në bazë të aftësive dhe kualifikimeve, si dhe mungesës së sigurisë në punë, të ndikuar nga përkatësia politike (partiake) dhe ndryshimet qeveritare (King.R dhe Gëdeshi.I., 2020, f.57; FES, 2019)²⁴.

Shqetësimet dhe frikërat kryesore të të rinjve shqiptarë janë: të jesh i varfër, i papunë dhe viktimë e korrupsionit (f.17). Kështu, tre shqetësimet kryesore

²² Fondacioni "Friedrich Ebert". (2019). Rinia Shqiptare 2018/2018.

²³ Fondacioni "Friedrich Ebert". (2019). Rinia Shqiptare 2018/2018.

²⁴ King.R and Gëdeshi.I. (2020). The actual and potential migration of students from Albania: a putative Brain Drain?

që trembin të rinjtë janë: të jenë të varfër, të jenë të papunë dhe të jenë negativisht të ndikuar nga korrupsioni. Në linjë me këtë, është e rëndësishme të evidentohet se kultura dhe niveli i lartë i tolerancës ndaj korrupsionit dhe përdorimi i njohjeve dhe favoreve po ndikon dukshëm tek të rinjtë. Të rinjtë po shfaqin gjithmonë e më tepër shenja të pranimit dhe të tolerimit të praktikave joligjore dhe jolegjitime, sidomos për të zgjidhur çështje personale dhe për të gjetur një punë (FES, 2019, f.17, f.20).²⁵

Edhe sipas raportit të përvitshëm për Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit në botë, të publikuar nga Transparency International (2022)²⁶, Shqipëria ka pasur një rënie prej një pike në krahasim me vitin e kaluar, nga 36 në 35 pikë në indeksin e Korrupsionit²⁷, duke shënuar regres dhe duke mbetur prapa vendeve të rajonit. Shqipëria mbetet në të njëjtat ujëra të turbullta me një progres minimal në luftën ndaj korrupsionit, ku një dekadë më parë, Indeksi i Korrupsionit tregonte 33 pikë.

Për më tepër, ka faktorë të tjerë socio-strukturalë që ndikojnë në largimin e të rinjve dhe elitës intelektuale nga Shqipëria si: sistemi i mirëqenies dhe mbrojtjes sociale, problemet në sistemin shëndetësor, ndotja, pasiguria fizike, mungesa e besimit në sistemin e drejtësisë dhe pakënaqësia me klasën politike (King.R dhe Gëdeshi.I., 2020, f.31; FES, 2019).



Mungesa e vëmendjes nga Qeveria / Apatia e Institucioneve dhe klasës politike

Largimi i të rinjve dhe trurit në masë nga Shqipëria, mbetet një e vërtetë e “padëshiruar”, që jehon prej kohësh në veshët e çdo qeverie, që deri më sot kanë rezultuar të shurdhër ndaj ndjeshmërisë që ka kjo çështje dhe përmasave të frikshme të këtij fenomeni. Deri më sot, nuk ka pasur një narrativë të qartë nga institucionet dhe klasa politike për të adresuar këtë problematikë, nuk ka pasur politika të orientuara drejt këtij fenomeni apo strategji të mirëfillta dhe afatgjata për të ndaluar rrjedhjen e vazhdueshme të trurit.

²⁵ Fondacioni “Friedrich Ebert”. (2019). Rinia Shqiptare 2018/2018.

²⁶ Transparency International.

²⁷ Transparency International përdor një sistem llogaritjeje të indeksit nga zero në 100 pikë, ku zero është niveli më i lartë i korrupsionit dhe 100 pikë do të thotë mungesë korrupsioni.

Një narrativë apatike dhe mospërfillëse ka shoqëruar fenomenin e largimit të të rinjve dhe trurit nga Shqipëria, ku shpeshherë merren në krahasim vendet e rajonit për numrin e të rinjve që largohen, duke e përgjithësuar dhe duke e konsideruar largimin e të rinjve si një fenomen normal që vjen si rrjedhojë e lëvizjes së lirë në një shoqëri të globalizuar. Në rastin e Shqipërisë, ikja e të rinjve nuk mund të konsiderohet si një rrjedhë normale e globalizimit të mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe profesionistëve, kur humbja e kapitalit më të çmuar njerëzor në të gjitha nivelet e studimit, nga bachelor-i në studimet doktorale, është shumë herë më e lartë nga çfarë përjetohet nga pothuajse të gjitha vendet e rajonit dhe më gjerë.

Në Shqipëri nuk ka shifra të sakta zyrtare, lidhur me numrin e të rinjve, studentëve, apo akademikëve që janë larguar për të studiuar, punuar dhe jetuar jashtë Shqipërisë. Nga institucionet zyrtare në Shqipëri, informacionet dhe statistikat mbi emigrimin e të rinjve dhe specifikisht në formën e largimit të trurit, janë minimale. Të dhënat janë thuajse të pakonsiderueshme për të matur apo për të bërë një pasqyrim të përmasave reale të këtij fenomeni. Duke mos pasur një panoramë të qartë të këtij fenomeni, aq më e vështirë bëhet ndërhyrja dhe synimi për të parandaluar eksodin e madh të të rinjve.

Gjatë periudhës së realizimit të këtij raporti mentorues, u mundësua komunikimi nëpërmjet një kërkesë për informacion nga ana e Qëndresës Qytetare drejt Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), ku u kërkua informacion nëse MAS disponon të dhëna të një natyre sasiore dhe cilësore të të rinjve që janë pjesë e sistemit arsimor shqiptar dhe largohen për të ndjekur arsimin jashtë Shqipërisë.

Referuar kthim-përgjigjes, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit u pohua se nuk disponohej një databazë lidhur me të rinjtë që lënë vendin për të studiuar jashtë Shqipërisë. E vetmja gjurmë, sipas MAS, për të pasur një numër të të rinjve që lënë vendin për studime jashtë vendit, është tërheqja e diplomave të maturës shtetërore në fillim të muajit korrik, para pjesës më të madhe të maturanëve. Në



këtë rast mbetet një numër hipotetik që pamundëson identifikimin e përmasave reale të largimit.



Në Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020²⁸, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 383, datë 6 maj 2015, nga ish-Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nuk preket specifikisht në asnjë prej 6 objektivave themelore të Planit ndërhyrja për të reduktuar përmasat e fenomenit të largimit të të rinjve dhe “trurit”, si dhe evidentimi i strategjive apo iniciativave të veçanta për të synuar që të rinjtë e larguar nga Shqipëria, të kthehen dhe të kontribuojnë në vend. Madje, duket se largimi i trurit dhe i të rinjve mbetet thujtë jashtë fokusit të këtij Plani. Mbetet ende për tu ndarë me publikun e gjerë se sa objektivat këtij Plani Kombëtar të Veprimit për Rininë janë përmbushur konkretisht. Sa të rinj janë

mbështetur, sa prej tyre janë ndjerë dhe janë përfshirë realisht në proceset politike dhe vendimmarrëse? A ka pasur ndikim në perceptimin e të rinjve dhe aspiratat e tyre për të parë të ardhmen në Shqipëri dhe jo gjëkund? Me qëllim funksionimin sa më rigoroz të strategjisë, Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë iu akorduan 543,206,000 lekë vetëm nga Buxheti i Shtetit, për harkun kohor 2015-2020.

Ende nuk ka një raport monitorimi dhe vlerësimi nga strukturat e ngarkuara me këtë funksion për zbatimin e planit, si dhe të dhëna për realizimin e plotë të objektivave të tij.

Institucionet shqiptare duhet të ridimensionojnë qasjen indiferente ndaj kësaj çështjeje dhe të konsiderojnë në mënyrë serioze të gjitha pasojat afatgjata që mbart largimi i të rinjve dhe elitës intelektuale nga Shqipëria. Është e nevojshme një qasje sistemike dhe shumë dimensionale kundrejt kësaj çështjeje të rëndësishme për të ardhmen e vendit.


Mbetet një sfidë e vërtetë dhe e vështirë të mbash të rinjtë në vend, si dhe të tërheqësh ata të rinj dhe elitën intelektuale që ka lënë vendin të rikthehen në Shqipëri, ku lehtësisht shihet një mungesë e besimit dhe dëshirës për të besuar në një kthim të mundshëm të tyre. Arsyeet mund të gjenden në tranzicionin e stërzgjatur dhe të vështirë të Shqipërisë, dhe sidomos te korrupsioni, konfliktualiteti e polarizimi ekstrem në sferën politike shqiptare.

²⁸ Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020.

Në Strategjinë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2019 – 2022, parashikohet se “mund të eksplorohet mundësia e krijimit të një fondi bursash për studime të mëtejshme jashtë vendit dhe pjesëmarrja në programet e shkëmbimit me kusht detyrimin e kthimit (f.22)”. Në linjë me këtë, në strategji evidentohet se ende nuk ka një mekanizëm të qëndrueshëm që të punojë në parandalimin e rrjedhjes së trurit, ku në Planin e Veprimit 2019-2022, përcaktohet se duhet të vlerësohen rezultatet e nismave të marra deri tani dhe me anë të konsultimeve ndër-institucionale, të përcaktohet një mekanizëm i përhershëm që pengon “rrjedhjen e trurit” të shtetasve shqiptarë (f.71).²⁹

Por, në anën tjetër, vendimi i marrë nga Kryeministri ishte **mbyllja e Programit të Fondit të Ekselencës**.³⁰ Ky program synonte mbështetjen financiare për studentët shqiptarë të shkëlqyer, si dhe për nëpunësit civilë të administratës shtetërore, të cilët janë pranuar të kryejnë studimet e ciklit të parë, të dytë dhe studimet e doktoratës jashtë vendit në universitetet më të mira të botës sipas renditjes së Times Higher Education. Studentët dhe doktorantët, që përfitonin bursë nga Fondi i Ekselencës, kishin obligimin që pas përfundimit të studimeve të jepnin kontributin e tyre për tre vjet në Shqipëri, ndërsa punonjësit e administratës publike për 4 vjet në administratën shtetërore.

Mbi këtë program shpeshherë janë ngritur pikëpyetje lidhur me transparencën dhe manifestimin e lidhjeve dhe nepotizmit në formën më evidente, ku bazuar në listat e përfituesve, të publikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, është vënë re një tendencë e personave të lidhur me pushtetin dhe klasën politike. Kryeministri, në publik, argumentoi se një pjesë e mirë e përfituesve nuk ktheheshin më në Shqipëri për të kontribuar në administratën publike, duke e bërë jo efektive këtë skemë³¹, gjë e cila vërteton se institucioni përgjegjës,



²⁹ Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2019 – 2022.

³⁰ Vendim Nr.483, datë 16.07.2014, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i ekselencës)

³¹ <https://arsimi.gov.al/fondi-i-ekselencës/>

në këtë rast MAS, nuk ia ka dalë të përmbushë me sukses zbatimin e këtij programi. Për më tepër, në Shqipëri akoma mungon koordinimi ndër-institucional për t'u gjetur profesionistëve të kthyer pozicionet e duhura për të maksimizuar njohuritë dhe aftësitë e fituara. Duke marrë në konsideratë se strategjitë që kanë në synim qarkullimin e trurit si një alternativë ndaj largimit të përhershëm janë ato më efikase për të minimizuar përmasat e largimit të të rinjve dhe profesionistëve, mbyllja e këtij programi për të ridimensionuar dhe për ta zëvendësuar në programe të tjera, nxjerr në pah kulturën e pavazhdimësisë që e ka karakterizuar shtetin Shqiptar në këto vite.

Mungesa e vizionit afatgjatë, vazhdimësisë dhe stabilitetit në politikëbërje, frymës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve dhe karakteri konfliktual i politikës shqiptare në përgjithësi, kanë qenë pengesa serioze për realizimin me efikasitet të strategjive dhe politikave në Shqipëri ndër vite.

Një shembull konkret i moskoordinimit ndër-institucional është Programi Brain Gain³², një iniciativë e Qeverisë Shqiptare e nisur në vitin 2006 dhe e mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin në Shqipëri, që synonte të angazhonte diasporën shqiptare në zhvillimin e vendit dhe të reduktonte efektet ekonomike dhe sociale të ikjes së trurit.

Nëse risjellim vëmendjen në problemet e arsimit të lartë, duket se qeverisja aktuale ka ndërmarrë një tjetër hap në një tjetër drejtim, që nuk duket se kërkon të fokusohet në trajtimin e problemeve që paraqet arsimit të lartë. Kryeministri ka shprehur në publik iniciativën për të hapur rrugën për të sjellë universitetet e huaja në Shqipëri, në mënyrë që studentët të kenë diploma të cilat do të jenë të vlefshme dhe jashtë vendit, dhe në këtë mënyrë studentët shqiptarë nuk do të ikin, por do të qëndrojnë në Shqipëri.

Ofrimi i mundësisë studentëve shqiptarë të ndjekin arsimin e lartë në universitete të huaja në Shqipëri është një iniciativë në pamje të parë për t'u përgëzuar. Megjithatë, nën një tjetër perspektivë, fokusi në zgjidhjen e një problemi, në këtë rast të largimit të të rinjve, duke mos i kushtuar vëmendje zgjidhjes së problemeve në sistemin aktual të arsimit, mbart në vetvete kosto sociale dhe ekonomike për Universitetet në Shqipëri dhe studentët që studiojnë në to. Duke synuar sjelljen e universiteteve të huaja


³² Council of Ministers & UNDP. (2006).

në Shqipëri, më tepër se të përpjekurit për t'i dhënë zgjidhje problemeve të arsimit të lartë, zhvlerëson dhe i çon Universitetet publike në një rrugë pa krye, drejt shterimit dhe “vdekjes akademike”.

Një tjetër aspekt i largimit të studentëve dhe të rinjve shqiptarë është mungesa e kapitalizimit të potencialit profesional të të rinjve dhe elitës intelektuale që lënë vendin. Mungojnë pikat dhe rrjetet e lidhjes mes tyre për të bashkëvepruar dhe për të kanalizuar ndikimin e tyre në Shqipëri.

Gjithashtu, evidentohet në studimin e kryer nga King.R dhe Gëdeshi.I. (2020) (fq.85), që studentët të cilët studiojnë jashtë Shqipërisë theksojnë apatinë dhe mungesën e prezencës së misioneve diplomatike shqiptare në nxitjen e lidhjeve mes studentëve, profesionistëve të kualifikuar dhe insitucioneve të vendit.

Duke pasur në konsideratë se kapitali njerëzor gjithkund në diasporë është një pasuri e jashtëzakonshme dhe e pashfrytëzuar në dobi të vendit, pasja e strategjive dhe politikave tërheqëse për qarkullimin e trurit nga diaspora do të sillte përfitime të paçmueshme për Shqipërinë (Komisioni Evropian, 2021, f.99)³³



³³ European Commission. (2021). Albania 2021 Report.




Rekomandime



Zhvillimi i një kuadri të politikave dhe strategjive me në qendër emigracionin qarkullues të të rinjve. Ky do të ishte një hap domethënës që qeveria shqiptare mund të ndërmarrë për të reduktuar impaktin që ka "largimi i trurit". Programet e emigracionit ciklik u mundësojnë njerëzve të punojnë dhe të specializohen në profesionet e tyre për disa vite jashtë vendit, e më pas të kthehen në vendin e tyre të origjinës.



Rritja e shkallës së punësimit, punësimit të qëndrueshëm, afatgjatë dhe me standarde. Sfidë tjetër ngelet rritja e zbatueshmërisë në praktikë, në mënyrë objektive, e programeve për nxitjen e punësimit. Financimet dhe iniciativat për nxitjen e punësimit të bëhen në mënyrë transparente, të hapura dhe sipas meritës.



Për ta bërë administratën publike shqiptare një destinacion profesional tërheqës për të rinjtë e mirë arsimuar, është e rëndësishme të reflektojmë mbi raportin kosto-përfitim që ndikon në vendimmarrjen e të kthyerit potencial në Shqipëri. Faktorët që ndikojnë në vendimmarrjen e këtyre të rinjve janë së pari, të ardhurat, përfitimet, siguria në punë dhe perspektiva e një karriere bazuar në meritokraci. Të rinjtë duhet të besojnë se ka hapësirë për të bërë karrierë brenda institucioneve shtetërore.



Është e rëndësishme të hulumtohet dhe analizohet fenomeni i largimit të të rinjve në formën e "largimit të trurit", në mënyrë që të kemi një panoramë të qartë të përmasave dhe faktorëve nxitës që qëndrojnë pas këtij fenomeni. Vetëm duke pasur një panoramë të qartë të fenomenit do mund të zhvillohen strategji dhe programe të vlefshme për të reduktuar pasojat e rënda që mbart largimi i pjesës më të gjallë të shoqërisë.



Ndjekja e një strategjie afatgjatë e "Qarkullimit të trurit" nga institucionet shqiptare për të rinjtë e kualifikuar do të shmangte në mënyrë indirekte "rrjedhjen e trurit" nga Shqipëria drejt vendeve të zhvilluara.

Referenca

Westminster Foundation for Democracy & Institute for Development and Innovation. (2020) The Cost of Youth Emigration in Western Balkan Countries: Regional Overview.

Aksesuar në: <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2021/08/WFD-COYE-ENG-ALL.pdf>

King, Russell. (2005). Albania as a Laboratory for the Study of Migration and Development. Journal of Southern Europe and the Balkans. 7. 133-155. 10.1080/14613190500132880.

Aksesuar në:

https://www.researchgate.net/publication/249003584_Albania_as_a_Laboratory_for_the_Study_of_Migration_and_Developmen

INSTAT. (2020). Diaspora e Shqipërisë në shifra.

Aksesuar në: <http://www.instat.gov.al/media/7848/diaspora-ne-shifra-2020.pdf>

Gëdeshi.I. (2021). How Migration, Human Capital and The Labour Market Interact In Albania

Aksesuar në: https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/2021-09/migration_albania.pdf

The Vienna Institute for International Economic Studies. Leitner M. S. (2021). Net Migration and its Skill Composition in the Western Balkan Countries between 2010 and 2019: Results from a Cohort Approach Analysis.

Aksesuar në: <https://www.ac.at/net-migration-and-its-skill-composition-in-the-western-balkan-countries-between-2010-and-2019-results-from-a-cohort-approach-analysis-dlp-5695.pdf>

INSTAT & IOM. (2014) Return Migration and Reintegration in Albania 2013. ISBN: 978-9928-188-14-4

Aksesuar në:

<https://albania.iom.int/sites/albania/files/publication/15.%20Return%20Migration%20and%20Reintegration%20in%20Albania%202013.pdf>

Gjypi.Sh.A. (2018). Largimi i Mjekëve nga Shqipëria "Together for Life" & Friedrich Ebert Foundation.

Aksesuar në: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14924.pdf>

King.R and Gëdeshi.I. (2020). The actual and potential migration of students from Albania: a putative Brain Drain?

Aksesuar në: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/17258.pdf>

INSTAT. (2020). Diaspora e Shqipërisë në Shifra.

Aksesuar në: <http://www.instat.gov.al/media/7848/diaspora-ne-shifra-2020.pdf>

Transparency International.

Aksesuar në: <https://www.transparency.org/en/countries/albania>

Gallup. (2016).

Aksesuar në:

<https://news.gallup.com/poll/240938/balkan-neighbors-hopeful-worlds-apart-migrants.aspx>

Transparency International.

Aksesuar në: <https://www.transparency.org/en/countries/albania>

Governmental Sources

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020.

Aksesuar në: <https://arsimi.gov.al/plani-kombetar-i-veprimit-per-rinine-2015-2020/>

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2019 – 2022.

Aksesuar në: https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Migracionin-dhe-Plani-i-Veprimit_2019-2022.pdf

Vendim Nr.483, datë 16.07.2014. "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nënpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i ekselencës)"

Aksesuar në: <https://arsimi.gov.al/fondi-i-ekselences/>

Council of Ministers & UNDP. (2006).

Aksesuar në: <https://info.undp.org/docs/pdc/Documents/ALB/Brain%20Gain%20ProDoc.pdf>

<https://diaspora.gov.al/miratohet-strategjia-kombetare-e-diaspores-shqiptare-2021-2025/>

https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2018/08/komunikata_fondi_ekselences_1.pdf

<https://diaspora.gov.al/ep-content/uploads/2020/08/STRATEGJIA-KOMBETARE-E-DIASPORES-2021-2025-2.pdf>

Media

Deutsche Welle. Aksesuar në <https://www.dw.com/sq/shqip%C3%ABri-largimi-i-turit-shkak-ekonomia-siguria-publike-dhe-institucionet-e-dob%C3%ABta/a-41975744>

Top Channel. Aksesuar në: <https://top-channel.tv/2022/01/25/transparency-4international-4publikon-raportin-shqiperia-nje-pike-renie-ne-indeksin-e-korrupsionit/>

Euronews.al. Aksesuar në: <https://euronews.al/vendi/aktualitet/2021/09/10/largimi-i-te-rinjve-nga-shqiperia-riten-kerkesat-per-punesim-drejt-vendeve-te-huaja/>

Reporter.al

Aksesuar në: <https://www.reporter.al/2020/11/05/eksodi-i-te-rinjve-cila-eshte-faturo-qe-duhet-te-paguajme/>



#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

Ky raport publikohet në kuadër të nismës së Qëndresës Qytetare për të nxitur transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED)

Analistët e rinj të politikave publike të angazhuar në këtë nismë do të prodhojnë raporte monitoruese periodike në fushat kryesore të qeverisjes dhe do të angazhohen në përpjekje për avokim me zyrtarë të shtetit, ligjvënësit, ekspertë dhe shoqërinë civile për të promovuar rekomandime që do të rrisin transparencën dhe përgjegjshmërinë e zyrtarëve dhe qeverisë. Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport i përkasin autorit realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e National Endowment for Democracy (NED) dhe Qëndresës Qytetare.



www.qeverisja.qq.com.al

RAPORT MONITORIMI

Rinia

Nentor-Janar 2022